

Mevlude Aliu-Gashi
Zehrie Plakolli

SFIDAT DHE GATISHMËRIA E NIVELIT LOKAL PËR REALIZIMIN E EDUKIMIT PARAFILLOR SI EDUKIM I OBLIGUAR



Prishtinë, 2016

Mevlude Aliu-Gashi
Zehrie Plakolli

**SFIDAT DHE GATISHMËRIA E NIVELIT LOKAL
PËR REALIZIMIN E EDUKIMIT PARAFILLOR
SI EDUKIM I OBLIGUAR**

Raport hulumtimi

Prishtinë, 2016

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin:

Labëri Luzha

Autorë:

Mevlude Aliu-Gashi

Zehrie Plakolli

Recensent:

Prof. Dr. Demë Hoti

Këshilli Shkencor i IPK-së:

Prof.Dr. Hajrullah Koliqi

Prof.Dr. Naser Zabeli

Prof.Dr. Hatixhe Ismajli

Prof.Dr. Linda Grapci

Mr.Sc. Blerim Saqipi

Korrektues gjuhësor

Bedri Zyberaj

Përgatitja teknike

Skender Mekolli

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	5
PËRKUFIZIMI I TERMAVE	6
ABSTRAKT.....	7
1. HYRJE	11
2. KORNIZA KONCEPTUALE DHE TEORIKE.....	12
3. METODOLOGJIA	16
3.1. Qëllimi i hulumtimit	16
3.2. Pyetjet e hulumtimit.....	16
3.3. Modeli i hulumtimit	16
3.4. Hipoteza	16
3.5. Rëndësia e hulumtimit	17
3.6. Mostra	18
3.7. Instrumentet	19
3.8. Dinamika e hulumtimit	19
4. REZULTATET DHE INTERPERTIMI I TYRE.....	22
4.1. Informatat që kanë zyrtarët komunal të arsimit për edukimin parafillor si edukim i obliguar.....	22
4.2. Grupet parafillore në të gjitha format e organizmit të edukimit parafillor	23
4.3. Numri i fëmijëve të përfshirë në të gjitha format e organizimit të edukimit parafillor	23
4.4. Shkollat pa klasë parafillore	31
4.5. Hapësirat e realizimit të edukimit parafillor në shkolla.....	32
4.6. Numri i edukatorëve në edukimin parafillor.....	33

4.7. Struktura gjinore e edukatorëve në edukimin parafillor	34
4.8. Orari i punës së edukatoreve dhe shtrirja institucionale e edukimit parafillor.....	34
4.9. Përgatitja profesionale e edukatoreve parafillor	39
4.10. Gatishmëria e komunave për të përfshirë të gjithë fëmijët në edukimin parafillor.....	40
4.11. Objektet që mund të adaptohen për klasë parafillore.....	42
4.12. Komunitat që mbështeten nga donatorët.....	43
4.13. Mundësitë e komunave që në vitin 2016/17 të përfshijnë 100% të fëmijëve në edukimin parafillor.....	45
4.14. A e posedon DKA-ja, numrin e fëmijëve të lindur në vitin 2011, që në vitin shkollor 2016/2017 janë të moshës 5-6 vjeç?	46
4.15. Sigurimi i listave dhe numrit të fëmijëve që kanë moshën për t'u regjistruar në klasë parafillore, nga DKA-ja	48
5. SFIDAT E NIVELIT LOKAL PËR PËRFSHIRJEN E TË GJITHË FËMIJËVE NË EDUKIMIN PARAFILLOR	49
6. KONKLUDIME	52
7. REKOMANDIME	53
7.1. Rekomandimet për MASHT	53
7.2. Rekomandime për Komunitat	53
LITERATURA.....	55
SHTOJCAT	57

SHKURTESAT

ARC	Agjencioni për Regjistrim Civil
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
SNKA	Standardi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
QBK	Qendra me bazë në komunitet
UA	Udhëzim administrativ
IP	Institucione Parashkollore

PËRKUFIZIMI I TERMAVE

Edukim parashkollor: i referohet edukimit të hershëm nga edukatorët e njohur për fëmijët e moshës parashkollore.

Edukim parafillor: i referohet nivelit të edukimit të fëmijëve të moshës 5-6 vjet nga edukatorët e njohur në institucionet parashkollore

Qendra me bazë në Komunitet: objekt në të cilin organizohet edukimi parashkollor/parafillor, por që financohen nga komuniteti (prindërit, OJQ-të, etj), me qëndrim gjysmë ditor.

Edukator/Mësimdhënës: personi i kualifikuar sipas dispozitave të ligjit mbi arsimin parauniversitar me përgatitje akademike dhe profesionale, i punësuar për ofrimin e shërbimeve arsimore për fëmijët/nxënësit.

Institucione parashkollore: mund të definojnë objektet apo shtëpitë e konvertuara të cilat janë të ndërtuara në mënyrë speciale për të ofruar programe parashkollore dhe të cilat plotësojnë nevojat edukative dhe zhvillojnë nevojat e fëmijëve deri në regjistrimin e tyre në shkollë fillore. Këto institucione ofrojnë shërbime të cilat janë me orar të plotë apo gjysmë orari dhe mund të zgjatet orari edhe gjatë shërbimit të mbrëmjes.

FALËNDERIM

Instituti Pedagogjik i Kosovës falënderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë hulumtim për gatishmërinë e bashkëpunimit si dhe objektivitetin e informacionit të ofruar.

ABSTRAKT

Zbatimi i politikave arsimore nga niveli qendror, niveli lokal dhe institucionet edukative, është shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm, për të arritur zhvillimin e të gjitha niveleve të edukimit. Për t'u zbatuar këto politika niveli lokal shpesh has në barriera dhe vështirësi të ndryshme.

Ky hulumtim ka për qëllim të identifikojë sfidat dhe gatishmërinë e nivelit lokal, për të realizuar edukimin parafillor si edukim i obliguar.

Respondentët e këtij hulumtimi janë zyrtarët komunal të arsimit të 30 komunave, udhëheqësit e 48 institucioneve parashkollore private dhe udhëheqësi e sektorit për administrim në bazë të të dhënave në Agjencionin e Regjistrimit Civil të Kosovës.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se hipoteza „niveli lokal, nuk është i gatshëm, të realizojë edukimin parafillor si edukim të obliguar” është e qëndrueshme. Sipas gjetjeve, vetëm 10% e komunave kanë të përfshirë të gjithë fëmijët në edukimin parafillor. Nga të gjithë fëmijë e lindur, në vitin 2010 (sipas ARC), e që në vitin shkollor 2016/2017 janë të moshës 5-6 vjet, të përfshirë në edukim parafillor janë 80.2% dhe të papërfshirë janë 19.8 % e tyre.

Janë 127 shkolla që ende nuk kanë klasë parafillore. Janë 154 klasa parafillore, ku në ato klasë mësojnë edhe nxënësit e niveleve më të larta të shkollimit dhe nuk janë të përshtatshme për realizimin e edukimit parafillor. Kjo tregon se derisa ende nuk janë të përfshirë të gjithë fëmijët në edukimin parafillor, ka vështirësi dhe ende nuk janë krijuar kushtet që edukimi parafillor të bëhet i obliguar.

Sipas gjetjeve, komunat bëjnë përpjekje për të rritur përfshirjen e fëmijëve dhe për të krijuar kushte që ky nivel i edukimit të bëhet i obliguar, por, për shkak të mungesës së buxhetit, të pamundësisë për të rritur numrin e edukatoreve, mungesës së hapësirave, etj, ende nuk kanë arritur që t'i përfshinjë të gjithë fëmijët në këtë nivel të edukimit.

Rekomandimet kryesore për të tejkaluar sfidat, që edukimi parafillor të bëhet i obliguar, janë: mbështetja e fuqishme të nivelit qendror, për nivelin lokal dhe zbatimi i ligjeve në fuqi për këtë nivel të edukimit.

ABSTRACT

Implementation of educational policies by the central level in local level and educational institutions is very important and necessary to ensure the development of all levels of education. However, the local level often faces different barriers and difficulties in implementing these policies.

This survey aims to identify challenges and readiness of the local level to implement pre-primary education as compulsory education.

Respondents of this survey are municipal education officials of 30 municipalities, heads of 48 private pre-primary institutions and heads of the sector for administration of databases in the Kosovo Civil Registration Agency.

Results of the survey confirm the hypothesis that “the local level is not prepared to implement the pre-primary education as compulsory education.” Based on the findings, only 10% of municipalities have all children included in pre-primary education. Out of total children born in 2010 (according to CRA), which in the school year 2016/2017 were aged 5-6 years old, 80.2% are included in pre-primary education and 19.8% are not included.

There are 127 schools that still do not have pre-primary classrooms. There are 154 pre-primary classrooms where pupils of higher education levels also attend lessons and they are not suitable for pre-primary education. This shows that while not all children are included in pre-primary education, there are difficulties and there are not conditions to make the pre-primary education compulsory.

Based on the findings, municipalities try to improve the inclusion of children and create conditions for making this level of education as compulsory; however, due to the lack of budget and inability to increase the number of teachers, lack of premises, etc., they did not manage to include all children at this level of education.

The main recommendations to overcome challenges in order to make the pre-primary education compulsory are: strong support of the central level to the local level and implementation of applicable laws for this level of education.

1. HYRJE

Duke u bazuar në përpjekjet për reformimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë dhe në të gjithë dokumentacionin përmes të cilit realizohet arsimi e reformat e tij, shohim që i është kushtuar shumë kujdes faktit që, vitet e hershme të të nxëniet, janë vendimtare për zhvillimin e fëmijës. Nga ky fakt, kushtëzohet rëndësia e zhvillimit të edukimit parashkollor të ne dhe kudo në botë. Kurse nevoja e parapërgatitjes së fëmijëve për shkollë, ka rezultuar me funksionimin e nivelit të veçantë, në kuadër të edukimit parashkollor, pra nivelit të edukimit parafillor, me fëmijët e moshës 5-6 vjeç. Ky nivel edukimi, ka një hapësirë të veçantë të Ligji për Edukimin Parashkollor e, e po ashtu edhe të Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016.

Pastaj, një prej dy objektivave të përgjithshme të PSAK-ut lidhur me Edukimin Parashkollor është që: „Deri në vitin 2016, parashihet që të gjithë fëmijët e moshës 5-6 vjeçare të përfshihen në arsimin parafillor” (fq.58) Kjo, natyrisht që mund të arrihet vetëm nëpërmes të krijimit të kushteve, avancimit të Kurrikulës për këtë nivel edukimi, përmes avancimit të materialeve mësimore-mjeteve didaktike dhe lojës, përmes avancimit të programeve për zhvillimin profesional të edukatoreve, përmes ngritjes së vetëdijes së komunitetit dhe të prindërve për këtë nivel edukimi, nëpërmes fushatave vetëdijësuese, seminareve e trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera dedikuar prindërve dhe edukatoreve, përmes zhvillimit të infrastrukturës fizike etj. Përgjegjësia, për krejt këto aktivitete i takon MASHT-it dhe DKA-ve.

Në kuadër të kësaj çështjeje zhvillimore të edukimit parafillor, është imponuar nevoja, që të realizohet ky hulumtim, i cili i paraqet të dhënat reale të sfidave dhe gatishmërinë e DKA-ve, në shumë aspekte; në aspektin e sigurimit të resurseve profesionale (edukatoreve), të infrastrukturës fizike, shkollore të përshtatshme për moshën 5-6 vjeç, si dhe sigurimin e buxhetit të nevojshëm, për përfshirjen e tërësishme(100%), të fëmijëve të kësaj moshe, në edukimin parafillor. Këto të dhëna, pastaj mund të merren parasysh nga kompetentët dhe të orientojnë aktivitetet e tyre, aty ku ka nevojë dhe ngecje eventuale, për ta realizuar këtë objektivë të PSAK-ut dhe synim të ligjit për edukim parashkollor.

2. KORNIZA KONCEPTUALE DHE TEORIKE

Edukimi parafillor si dhe edukimi parashkollor në përgjithësi, në Kosovë, ka përfshirje jo të kënaqshme. MASHT-i është duke i kushtuar më shumë rëndësi këtij niveli të edukimit, për arsye se kjo e mundëson ngritjen e cilësisë së edukimit dhe arsimit në nivele më të larta.

Të gjithë faktorët që ndikojnë në edukimin parafillor janë duke bërë përpjekje që korniza ligjore të zbatohet dhe të arrihen synimet e parapara për cilësinë në arsim. Ky hulumtim u mundëson faktorëve relevant, që të kenë rezultate të sakta nga terreni për të zhvilluar proceset e mëtutjeshme të kësaj fushe.

Lidhur me edukimin parafillor si edukim i obliguar, Kosova mund të krahasohet me vendet e rajonit, ku ky nivel i edukimit, ende nuk është i obliguar, si në Shqipëri, në Mal të Zi, në Maqedoni, etj, ndërsa, mbetet shumë larg shteteve si: Anglia, Franca, Irlanda,

Skocia, Gjermania, etj, që edukimin parafillor e kanë të obliguar për fëmijët nga moshë 4 vjeçare.

Sa i përket përfshirjes së fëmijëve në edukim parafillor, sipas këtij hulumtimi, në Kosovë, përfshirja është ende e ulët 80.2% e fëmijëve të moshës 5-6 vjeç janë të përfshirë në edukimin parafillor.

Sipas të dhënave të UNESCO-s, përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor, një vit para fillimit të shkollës, në vendet e zhvilluara të Evropës është e lartë, (për Shërbull, në Itali mbi 96%, në Holandë 100%, në Spanjë rreth 70%, në Francë 100% etj) (Save the Children, 2014,f.18)

Lidhur me shkallën e përfshirjes dhe mospërfshirjes së fëmijëve në edukimin parafillor është bërë një hulumtim, në vitin 2013, nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, e po ashtu, janë edhe të dhënat statistikore për edukimin parashkollor/parafillor publik, që prezanton zyra e statistikave në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Ndërsa, ky hulumtim përfshinë edhe edukimin parafillor privat të licencuar, dhe qendrat me bazë në komunitet, si dhe të dhëna të veçanta për gatishmërinë dhe sfidat e komunave për edukimin parafillor në përgjithësi dhe mundësitë për të bërë këtë nivel të edukimit si edukim të obliguar.

Duke marrë parasysh zhvillimin e hovshëm të fëmijëve në moshën parashkollor/parafillor, ky nivel i edukimit duhet të merret me shumë prioritet dhe t'i kushtohet rëndësi e veçantë nga të gjithë faktorët ndikues, që ky edukim të zë vendin që meriton në sistemin e arsimit në Kosovë.

Hulumtimet e ndryshme të kohëve të fundit kanë treguar se përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor prej një moshe më të re, ka një impakt mjaft pozitiv në zhvillimin e fëmijëve dhe

arritjet e tyre akademike përgjatë gjithë jetës, gjë e cila më pas reflektohet pozitivisht në komunitetin përreth dhe mbarë shoqërinë në përgjithësi.

Edukimi parafillor është faza e fundit e edukimit parashkollor. Në moshën 5-6 vjeç, zhvillimi trupor i fëmijës është më i fuqishëm, vazhdon procesi i zhvillimit të trurit, vazhdon zhvillimi i sistemit të muskulaturës dhe të eshtrave, zhvillimi i perceptimeve, i kujtesës, i imagjinatës, të menduarit kalon nga ai veprues, në të menduar konkret figurativ. Fëmijët, në këtë moshë, janë më kureshtarë, kanë fjalor më të pasur, zhvillohet edhe më tutje bota emocionale e tyre, thellohen ndjenjat estetike, morale, etj.

Duke mos e lënë anash rëndësinë e madhe të edukimit të fëmijëve në familje, në moshat më të hershme siç është mosha 0-3 vjeç, rëndësia e edukimit institucional është e pakontestueshme edhe për këtë moshë edhe për moshat më të rritura dhe realizohet përmes profesionistëve të edukimit parashkollor, ku fëmijët zhvillojnë personalitetin e tyre, krijojnë shprehitë dhe fitojnë shkathtësitë për jetë dhe për shkollë.

Në këtë moshë fëmijët merren me lloje të ndryshme të aktiviteteve të cilat ndikojnë në personalitetin e tij. „Fëmija aftësohet për punë në kopsht, për vetëshërbim, për veprimtari figurative me letër, plastelinë, baltë, etj”(Deva-Zuna, 2003, f. 48)

Fëmijët e kësaj moshe aftësohen në shumë mënyra, por kanë ende shumë nevojë për t'u zhvilluar dhe për të mësuar. „U nevojitet të praktikojnë zhvillimin e marrëdhënieve me të tjerët, u nevojitet të vazhdojnë përmirësimin e të menduarit dhe të aftësive bashkëbiseduese” (Instituti i Studimeve Pedagogjike, 2002, f. 44)

Edukimi në institucionet parashkollore/parafilllore, duhet të realizojë motivimin e fëmijëve për të mësuar, të nxisë kuriozitetin për dije. Institucionet parashkollore/parafillor, duhet të realizojnë një nivel të caktuar kërkesash që t'i përgjigjen rritjes së aftësive të fëmijës dhe përmbushjes së nevojave dhe interesave të fëmijëve.

E rëndësishme për fëmijën që do të shkoj në shkollë, është formimi jo vetëm i shprehive të sjelljes së kulturuar, por kthimi i tyre në zakone, që këto rregulla të bëhen normë e sjelljes së tyre. Fëmijët parashkollor duhet të përvetësojnë shprehitë e higjienës personale, shprehjet e kulturara, shprehitë e punës intelektuale, t'u bëhen zakon rregullat e para të marrëdhënieve me fëmijët, t'u mbillet dashuria për moshatarët, prindërit dhe mësuesit (Vadahi, 2002, f. 125)

Roli i edukimit parafillor është i pazëvendësueshëm për zhvillimin e fëmijëve dhe për përgatitjet për klasë të parë në shkollë.

Për këtë arsye është i nevojshëm edukimi parafillor si edukim i obliguar.

3. METODOLOGJIA

3.1. Qëllimi i hulumtimit

Identifikimi i sfidave dhe i nivelit të parapërgatitjes së Drejtorive Komunale të Arsimit, për funksionimin e edukimit parafillor si edukim i obliguar.

3.2. Pyetjet e hulumtimit

-Sa janë të gatshme komunat për krijimin e kushteve që edukimi parafillor të bëhet i obliguar?

-Cilat janë sfidat që duhet t'i tejkaloj niveli lokal, që të krijojë kushte për përfshirjen e të gjithë fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në edukim parafillor?

3.3. Modeli i hulumtimit

Hulumtimi është vlerësues dhe karakterizohet nga qasja kuantitative.

3.4. Hipoteza

Niveli lokal nuk është i gatshëm të realizojë Edukimin Parafillor, si edukim të obliguar

Arsyetim: Komunat ballafaqohen me sfida të ndryshme si mungesa e resurseve humane, hapësinore e materiale për të mundësuar përfshirjen e të gjithë fëmijëve në edukim parafillor.

3.5. Rëndësia e hulumtimit

Në Kornizën e re të Kurrikulës, edukimi parafillor (mosha 5-6 vjet) është pjesë e fazës së 1-rë kyçe të Kornizës së Kurrikulës, nivelit 0 të SNKA. Kjo do të thotë që fëmijët të shkojnë në klasë të parë me përgatitje paraprake edukative-arsimore dhe kjo përgatitje të ketë koherencë me përmbajtjet programore që do të marrin fëmijët në klasë të parë e tutje.

Viteve të fundit i është kushtuar rëndësi e veçantë edukimit parashkollor dhe ky nivel është bërë pjesë e të gjitha politikave edukativo-arsimore. Për këtë, politikat arsimore kanë hartuar, ligje, plane strategjike, kornizë të kurrikulës, standarde të përgjithshme 3-6 vjet, kurrikulë për edukim parashkollor 3-6 vjet, standarde të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet, e dokumente të tjera zyrtare që ndikojnë në zhvillimin e edukimit të fëmijëve në fëmijërinë e hershme.

Bazuar në Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës 39/L-068, neni 4, pika 4.1 dhe neni 5 pikat a, b, c; komuna i bartë këto përgjegjësi: krijimin e kushteve, ndërtimin e objekteve shkollore, punësimin e stafit profesional, regjistrimin e fëmijëve/nxënësve, etj, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar nga niveli 0 (parashkollor), 1 (fillor), 2 (të mesëm të ulët) dhe 3 (të mesëm të lartë).

Ndërsa, sipas këtij ligji, në nenin 3 dhe në të gjitha nënpikat e këtij neni, MASHT-i bart përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet e arsimit, hartimin e politikave (dokumenteve, standardeve), promovimin e sistemit gjithëpërfshirës, promovimin e bashkëpunimit shkollë-familje, etj.

Rezultatet e këtij hulumtimi mund të jenë tregues të nevojshëm për opinionin, për hartuesit e politikave të edukimit

parashkollor/parafillor, për realizuesit e këtij niveli të edukimit në komuna, për ngritjen e cilësisë në edukimin parafillor, etj.

3.6. Mostra

Në hulumtim janë përfshirë:

Zyrtarë të drejtorive komunale të arsimit, në 30 komuna, të cilët u janë përgjigjur kërkesave tona për bashkëpunim për marrjen e të dhënave lidhur me hulumtimin.



Figura 1. Komunat e përfshira në hulumtim

Në komunat Shtërpcë, Novobërdë dhe Dragash janë marrë të dhënat vetëm për klasat parafillore në kuadër të shkollave në gjuhen shqipe.

Në hulumtim, nuk janë përfshirë komunat: Zveqan, Leposaviq, Zubin Potok, Partesh, Klllokot, Ranillug, Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore.

Udhëheqësit e institucioneve parashkollore private

Për të siguruar të dhënat për fëmijët e moshës 5-6 vjet, në institucionet parashkollore private të licencuara, kemi realizuar hulumtimin në 48 institucione parashkollore private dhe nga këto 15 institucione, nuk kanë fëmijë të moshës 5-6 vjet, kanë vetëm të moshave tjera.

Udhëheqësi e sektorit për administrim në bazë të të dhënave në Agjencionin e Regjistrimit Civil të Kosovës

Nga Agjencioni janë marrë të dhënat për numrin e fëmijëve në të gjitha komunat e Kosovës. Por, për hulumtim për ta krahasuar me numrin e fëmijëve të përfshirë në edukimin parafillor, janë marrë vetëm numri i fëmijëve të lindur në ato 30 komuna që kanë qenë të përfshira në hulumtim (duke zbritur numrin e fëmijëve që kanë lindur në komunat që nuk janë përfshirë në hulumtim).

3.7. Instrumentet

Si instrumente për realizimin e hulumtimit u përdorën pyetësorët, të cilët janë përpiluar në mënyrë adekuate, për secilin resor që plotësonite objektivat tona të hulumtimit.

3.8. Dinamika e hulumtimit

Meqenëse edukimi parafillor është një domosdoshmëri, është paraqitur nevoja që të mblidhen të dhënat e sakta statistikore nga terreni, lidhur me realizimin e këtij niveli të edukimit në nivelin

lokal. Këto të dhëna janë siguruar nga ky hulumtim që ka realizuar Instituti Pedagogjik i Kosovës, i cili ka hartuar një plan të detajuar veprimi, për grumbullimin e të dhënave, kalendarin e realizimit, përbërjen e ekipit, etj. Po ashtu, është hartuar instrumenti i hulumtimit për DKA, për institucione parashkollore private dhe për ARC.

Hulumtimi në terren është realizuar në periudhën prill-maj 2016, dhe të dhënat pasqyrojnë përfshirjen e fëmijëve të moshës 5-6 vjeç, për këtë vit kalendarik, si dhe gatishmërinë e komunave për përfshirje më të lartë të fëmijëve në edukimin parafillor në vitin 2016/2017.

Për sigurimin e të dhënave, DKA-ve u janë dërguar pyetësorët në mënyrë elektronike, pastaj ekipi ka shkuar në secilën nga këto, për të realizuar grumbullimin e të dhënave. Kështu janë mbledhur të dhënat edhe nga institucionet parashkollore private edhe nga Agjencioni për Regjistrim Civil. Përpunimi i tyre është bërë me teknikat e përpunimit statistikor, është bërë analiza dhe krahasimi i të dhënave dhe është përgatitur raporti.

Gjatë realizimit të hulumtimit kemi hasur në gatishmërinë e pakursyer të zyrtarëve të drejtorive komunale të arsimit, për të na ofruar të dhënat më të fundit nga shkollat dhe institucionet parashkollore, për numrin e fëmijëve në edukim parafillor dhe për kuadrin profesional që punojnë me fëmijë e kësaj moshe, e po ashtu edhe për të gjitha detajet e kërkuara në pyetësor.

Institucionet parashkollore private i janë përgjigjur pozitivisht bashkëpunimit për realizimin e hulumtimit duke ofruar të dhënat e kërkuara në pyetësor.

Agjencioni për Regjistrim Civil, po ashtu ka ndihmuar në realizimin e këtij hulumtimi duke na ofruar të dhëna për fëmijët e lindur dhe të regjistruar në Kosovë, në vitin 2010. Këto të dhëna na kanë shërbyer për të siguruar përqindjen e përfshirjes së fëmijëve në edukim parafillor.

4. REZULTATET DHE INTERPERTIMI I TYRE

4.1. Informatat që kanë zyrtarët komunal të arsimit për edukimin parafillor si edukim i obliguar

93% e zyrtarëve komunal janë përgjigjur që e kanë informatën, ndërsa 7% janë përgjigjur që nuk e kanë informatën, që janë duke u bërë përpjekje që edukimi parafillor të bëhet i obliguar.

Ky rezultat tregon edhe përkushtimin e komunave lidhur me realizimin e edukimit parafillor, derisa 7% e komunave nuk e kanë as informatën që ky nivel i edukimit po synohet të bëhet i obliguar, as se si do të jetë përpjekja e tyre për të krijuar kushte më të mira për edukimin parafillor, për planifikimi më të mirë të punës si DKA, për përfshirje më të madhe të fëmijëve në edukim parafillor, etj.




Figura 2. Përqindja e komunave që kanë apo nuk kanë, informatën për edukimin parafillor që po synohet të bëhet i obliguar

4.2. Grupet parafillore në të gjitha format e organizmit të edukimit parafillor

Në tabelën 1 janë paraqitur të dhënat e përgjithshme për komunat e përfshira në hulumtim-, që janë 30 sosh: fëmijë parafillor në shkolla , që janë 899 grupe, fëmijë parafillor në kopshte, që janë 108 grupe, fëmijë parafillor në institucione private 69 grupe (duke përfshirë edhe tri institucione publiko-private), fëmijë parafillor në qendrat me bazë në komunitet që janë 13 grupe dhe numrin e përgjithshëm të grupeve me fëmijë parafillor të përfshirë në edukim parafillor - që janë 1089 grupe.

Tabela 1. Numri i grupeve parafillore në të gjitha format e organizimit të edukimit parafillor

Komuna	Klasat parafillore në shkolla	Grupet parafillor në IP publike	Grupet parafillor në IP private	Grupet parafillore në QBK	Gjithsej grupe me fëmijë 5-6vjet
30	899	108	69	13	1089

4.3. Numri i fëmijëve të përfshirë në të gjitha format e organizimit të edukimit parafillor

4.3.1. Fëmijët 5-6 vjeçar të përfshirë në edukimin parafillor, sipas komunave

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për numrin e fëmijëve parafillor për secilën komunë, në institucionet publike, të dhënat për fëmijët që vijnë në një program edukimi në institucionet private të licencuara, të dhënat për numrin e fëmijëve në Qendrat me Bazë në Komunitet – QBK.

Tabela 2. Numri i fëmijëve 5-6 vjeçar të përfshirë në edukim parafillor sipas komunave.

	Komuna	Numri i fëmijëve në klasat parafillore	Numri i fëmijëve në grupet parafillore në IP Publike	Numri i fëmijëve në grupe tparafillore në IP Private	Numri i fëmijëve në grupet parafillore në QBK	Gjithsej fëmijë parafillorë
1	Prishtinë	2202	396	313	32	2943
2	Fushë Kosovë	123	49	74	75	321
3	Drenas	957	60	19	0	1036
4	Podujevë	1194	15	12	0	1221
5	Obiliq	343	0	0	11	354
6	Ferizaj	1647	68	9	0	1724
7	Shtime	391	0	0	0	391
8	Lipjan	800	19	7	0	826
9	Hani i Elezit	149	0	0	0	149
10	Kaçanik	295	161	0	0	456
11	Gjakovë	1110	271	159	65	1605
12	Rahovec	827	12	0	0	839
13	Malishevë	1106	0	0	0	1106
14	Gjilan	1120	75	75	0	1270
15	Kamenicë	285	0	0	0	285
16	Viti	524	12	0	0	536
17	Novobërdë	123	0	0	0	123
18	Mitrovicë	865	52	17	12	946
19	Skenderaj	730	17	0	5	752
20	Vushtrri	739	46	21	0	806
21	Pejë	1145	47	28	0	1220
22	Istog	464	76	0	0	540
23	Klinë	429	42	19	0	490
24	Deçan	528	0	0	0	528
25	Prizren	1793	0	36	0	1829
26	Suharekë	763	67	29	0	859
27	Junik	55	0	0	0	55
28	Dragash	385	0	0	0	385
29	Mamushë	68	0	0	0	68
30	Shtërpçë	35	0	0	0	35
	Gjithsej	21195	1485	818	200	23698

Tabela 3. Numri i fëmijëve 5-6 vjeçar të përfshirë në edukim parafillor sipas gjinisë.

Nr	Komuna	Numri i fëmijëve në klasat parafillore		Numri i fëmijëve në grupet parafillore në IP Publike		Numri i fëmijëve në grupet parafillore në IP Private		Numri i fëmijëve në grupet parafillore në QBK		Gjithsej fëmijë parafillor	
		F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
1	Prishtinë	1100	1102	201	195	148	165	15	17	1464	1479
2	Fushë Kosovë	68	55	26	23	39	35	32	43	165	156
3	Drenas	476	481	31	29	9	10	0	0	516	520
4	Podujevë	564	630	6	9	6	6	0	0	576	645
5	Obiliq	174	169	0	0	0	0	5	6	179	175
6	Ferizaj	830	817	33	35	3	6	0	0	866	858
7	Shtime	186	205	0	0	0	0	0	0	186	205
8	Lipjan	374	426	7	12	4	3	0	0	385	441
9	Hani i Elezit	78	71	0	0	0	0	0	0	78	71
10	Kaçanik	142	153	78	83	0	0	0	0	220	236
11	Gjakovë	496	614	120	151	71	88	31	34	718	887
12	Rahovec	407	420	8	4	0	0	0	0	415	424
13	Malishevë	538	568	0	0	0	0	0	0	538	568
14	Gjilan	579	541	42	33	24	51	0	0	645	625
15	Kamenicë	144	141	0	0	0	0	0	0	144	141
16	Viti	243	281	6	6	0	0	0	0	249	287
17	Novobërdë	52	71	0	0	0	0	0	0	52	71
18	Mitrovicë	399	466	28	24	7	10	7	5	441	505
19	Skenderaj	335	395	8	9	0	0	3	2	346	406
20	Vushtrri	363	376	24	22	10	11	0	0	397	409
21	Pejë	545	600	25	22	16	12	0	0	586	634
22	Istog	223	241	37	39	0	0	0	0	260	280
23	Klinë	219	210	19	23	11	8	0	0	249	241
24	Deçan	274	254	0	0	0	0	0	0	274	254

25	Prizren	857	936	0	0	17	19	0	0	874	955
26	Suharekë	372	391	29	38	9	20	0	0	410	449
27	Junik	23	32	0	0	0	0	0	0	23	32
28	Dragash	195	190	0	0	0	0	0	0	195	190
29	Mamushë	32	36	0	0	0	0	0	0	32	36
30	Shtërpçë	17	18	0	0	0	0	0	0	17	18
	Gjithsej	10305	10890	728	757	374	444	93	107	11500	12198

Siç shihet nga tabela 1 dhe 2, në klasat parafillore në shkolla janë gjithsej 21195 fëmijë 5-6 vjeçar, nga të cilët 10305 femra dhe 10890 meshkuj; në grupet parafillore në institucionet parashkollore publike janë 1485 fëmijë parafillor, nga të cilët 728 femra dhe 757 meshkuj; në grupet parafillore në institucionet parafillore private janë 818 fëmijë, nga të cilët 374 femra dhe 444 meshkuj; në qendrat me bazë në komunitet - QBK janë 200 fëmijë parafillor, nga të cilët 93 femra dhe 107 meshkuj. Numri i përgjithshëm është 23698 fëmijë parafillor (11500 femra dhe 12198 meshkuj).

Tabela 4. Numri dhe përqindja e përfshirjes së fëmijëve të moshës 5-6vjeç në edukimin parafillor publik (IP publike dhe shkolla), në IP private dhe në qendra me bazë në komunitet-QBK

	Numri i fëmijëve në institucionet publike	Numri i fëmijëve në institucionet private	Numri i fëmijëve në qendra me bazë në komunitet-QBK
	(Femra/Meshkuj)	(Femra/Meshkuj)	(Femra/Meshkuj)
Numri	22680 [11033; 11647]	818 [374; 444]	200 [93; 107]
Përqindja	95.7% [46.6%; 49.1%]	3.45 % [1.58 % ; 1.87%]	0.85% [0.40%; 0.45%]
Gjithsej	23698 [48.5% ; 51.5%]		




Figura 3. Përqindja e përfshirjes në edukim parafillor publik, privat dhe QBK

4.3.2. Të dhënat e Agjencionit për regjistrim civil për fëmijët e lindur në vitin 2010

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga Agjenconi i Regjistrimit Civil-ARC, numri i fëmijëve të lindur në vitin 2010 dhe që janë regjistruar në zyrat e regjistrimit civil është 29538 fëmijë, pra ky është dhe numri i fëmijëve të regjistruar në 30 komuna të Kosovës, që janë të përfshira në hulumtim. Nga numri 29538 fëmijë, 14184 janë femra dhe 15354 janë meshkuj. Sipas të dhënave nga zyrtarët e ARC-së, ne iu kemi referuar kësaj shifre për analiza të mëtejme, duke e konsideruar si nivelin 100% të përfshirjes së fëmijëve në edukimin parafillor.

4.3.3. Përqindja e përfshirjes së fëmijëve 5-6 vjeçar në edukimin parafillor në vitin 2016

Në Tabelën 4, është paraqitur krahasimi i numrit të fëmijëve të përfshirë në edukimin parafillor, në vitin shkollor 2015/2016, me numrin e fëmijëve që kanë lindur në vitin 2010. Pra, numri i përgjithshëm i fëmijëve të përfshirë në edukimin parafillor është 23698 fëmijë, ndërsa numri i fëmijëve që kanë lindur në vitin 2010 (sipas ARC, në këto 30 komuna që janë të përfshira në hulumtim) është 29538 fëmijë. Krahasimi i këtyre shifrave paraqet numrin e fëmijëve të pa përfshirë në edukim parafillor e që është 5840 fëmijë.

Tabela 5. Numri i fëmijëve të përfshirë në edukimin parafillor, krahasuar me numrin e fëmijëve të lindur në vitin 2010.

	Fëmijët e lindur në vitin 2010	Fëmijët e përfshirë në edukimin parafillor	Fëmijë të papërfshirë në edukim parafillor
Fëmijët	29538	23698	5840
Përqindja	100%	80.2%	19.8%




Figura 4 Përqindja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parafillor, krahasuar me numrin e fëmijëve të lindur në vitin 2010 (që në 2015/16 kanë moshën 5-6 vjeç)

4.3.4. Përqindja e përfshirjes në edukim parafillor sipas gjinisë

Tabela 6. Numri i fëmijëve femra/meshkuj të përfshirë dhe të papërfshirë në edukimin parafillor

	Fëmijë të lindur në vitin 2010 Femra/Meshkuj		Fëmijë të përfshirë në edukimin parafillor Femra/ Meshkuj		Fëmijë të papërfshirë në edukimin parafillor Femra/Meshkuj	
Numri	14184	15354	11500	12198	2684	3156
Përqindja	48%	52%	48.5%	51.5%	9.1%	10.7%




Figura 5. Krahasoni i numrit të fëmijëve të lindur në vitin 2010, të ndarë sipas gjinisë, me numrin e fëmijëve të përfshirë dhe të papërfshirë në edukimin parafillor sipas gjinisë.

Siç shihet edhe nga grafiku, fëmijë të lindur në vitin 2010 (në 30 komunitat që është realizuar hulumtimi) gjithsej janë 29538 fëmijë, nga të cilët 14184 (48%) janë femra dhe 15354 (52%) janë meshkuj; fëmijë të përfshirë në edukimin parafillor në vitin 2016 (në 30 komunitat që është realizuar hulumtimi) gjithsej janë 23698 fëmijë, nga të cilët 11500 (48.5%) janë femra dhe 12198 (51.5%)

janë meshkuj; fëmijë të papërfshirë në edukim parafillor janë 5840, nga të cilët 2684 (9.1%) janë femra dhe 3156 (10.7%) janë meshkuj.

6.3.5 Përqindja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parafillor sipas llojit të shërbimit të ofruar.

Tabela e mëposhtme ofron të dhënat për numrin e fëmijëve 5-6 vjeç, që vijnë në një program edukimi në njërin prej formave të organizimit, në klasat parafillore në shkollë, në grupet parafillore në institucione parashkollore publike, në grupet parashkollore private dhe në qendrat me bazë në komunitet.

Tabela 7. Numri i përfshirjes së fëmijëve në edukimin parafillor sipas llojit të shërbimit të ofruar

Komuna	Numri i fëmijëve në klasat parafillore	Numri i fëmijëve në grupet parafillore në IP Publike	Numri i fëmijëve në grupet parafillore në IP Private	Numri i fëmijëve në grupet parafillore në QBK
Numri	21195	1485	818	200
Përqindja	89.4%	6.3%	3.45%	0.85%




Figura 6. Përqindja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parafillor sipas llojit të shërbimit të ofruar

Rezultatet tregojnë që kemi këtë shpërndarje: fëmijë në klasat parafillore në shkolla janë 21195 (89.4%), fëmijë të moshës 5-6 vjeç në institucionet parashkollore publike janë 1485 (6.3%); fëmijë në institucione parashkollore private 818 (3.45%), fëmijë në qendrat me bazë në komunitet –QBK, janë 200 (0.85%).

Këtu shihet se institucionet parashkollore private, edhe pse në numër të madh përfshirja e fëmijëve parafillor, në këto institucione nuk është e lartë.

4.4. Shkollat pa klasë parafillore

Nga gjithsej 963 shkolla fillore të mesme të ulëta, në komunat që kemi realizuar hulumtimin, 836 shkolla kanë klasë parafillore dhe 127 shkolla nuk kanë klasë parafillore. Vetëm 6% e komunave i kanë të gjitha shkollat me klasë parafillore.




Figura 7. Numri i shkollave me klasë dhe pa klasë parafillore

4.5. Hapësirat e realizimit të edukimit parafillor në shkolla

- Klasa vetëm për parafillor në kuadër të shkollës, - 741 klasë;
- Në klasë ku mësojnë edhe nxënësit e niveleve tjera - 154 klasë;
- Në objekt të veçantë vetëm për klasën parafillore - 4 klasë.

Sipas kësaj statistike, shihet që 154 klasë –grupe, aktivitetin e realizojnë në ambient ku mësojnë nxënës të nivelit më të lartë dhe ai ambient, është shkollor, i pajisur vetëm me inventar elementar, (banka, karrige, tabelë e shkumës). Ky ambient, është i papërshtatshëm dhe e vështirëson realizimin e aktivitete adekuate – lojëra, për fëmijët e moshës 5-6 vjeç, sepse, aty mungojnë gjërat e nevojshme për funksionim të këtij niveli të edukimit.




Figura 8. Hapësirat në të cilat realizohet edukimi parafillor nëpër shkolla

4.6. Numri i edukatorëve në edukimin parafillor

Në nivel vendi, në shërbim të Edukimit Parafillor, pra, me fëmijët e moshës 5-6 vjeç, janë gjithsej 999 edukatorë. Prej tyre, 810 edukatorë janë në klasë parafillore në kuadër të shkollave, 118 edukatore në Institucionet Parashkollore Publike, 59 edukatore në Institucionet Parashkollore Private, kurse 12 edukatore, në Qendrat me Bazë në Komunitet. Vlen të theksohet që një numër i Institucioneve Parashkollore private, funksionojnë të palicencuara kurse në hulumtim, i kemi përfshirë vetëm ato të licencuarat ku nga 76 Institucione Parashkollore Private të licencuara nga MASHT- i sa janë gjithsej, të gatshme për bashkëpunim në hulumtim ishin vetëm 48 institucione parashkollore private, ku 15 nga ato, nuk kanë fëmijë të moshës 5-6 vjeç, të përfshirë nëpër grupe, kanë vetëm fëmijë të moshave më 0-5vjeç.




Figura 9. Numri i edukatoreve në edukimim parafillor

4.7. Struktura gjinore e edukatorëve në edukimin parafillor

Shikuar nga aspekti gjinor, përbërja e përgjithshme e edukatorëve të nivelit të edukimit parafillor është: 976 edukatore (femra) dhe 23 edukatorë (meshkuj). Edukatorët meshkuj, realizojnë punën e tyre në klasat parafillore në shkolla, ndërsa në institucione parashkollore publike, në institucione parashkollore private dhe në qendrat me bazë në komunitet, të gjitha edukatoret janë femra.




Figura 10. Përqindja e edukatorëve/reve në klasa parafillore në shkolla sipas gjinisë

4.8. Orari i punës së edukatoreve dhe shtrirja institucionale e edukimit parafillor

4.8.1 Orari i punës së edukatorëve në klasë parafillore në shkollë

Në 87% të komunave, edukatoret e realizojnë punën e tyre një edukatore me një grup të fëmijëve, në 10% të komunave edukatoret

e realizojnë punën një edukatore me dy grupe, ndërsa në 3% e komunave, diku edukatorët e realizojnë punën me një grup, e diku me dy grupe. Organizimi i këtij edukimi në mënyrë të padefinuar mirë dhe në mënyrë jo gjenerale, krijon edhe konfuzitet të DKA dhe në shkollat. Pritet që të zbatohet Udhëzimi Administrativ 19/2016, në të gjitha komunat, në mënyrë që ky nivel i edukimit të funksionojë njësoj sa i përket realizimit të orarit të punës së edukatorëve parafillorë.





Figura 11. Orari i punës së edukatorëve në realizimin e punës së tyre në shkollë

4.8.2. Komunat që kanë apo nuk kanë institucione parashkollore publike

Nga 30 komunat e përfshira në hulumtim, 22 prej tyre ose 73% kanë institucione parashkollore publike, kurse 27 % (8 komuna) nuk kanë fare.

Kjo tregon se po të kishte IP publike në të gjitha komunat, sigurisht që brenda tyre do të përfshiheshin fëmijë të të gjitha moshave parashkollore por edhe fëmijët e moshës 5-6 vjeç, dhe do të rritej

përqindja e përfshirjes së fëmijëve në edukim parafillor. Krahas rritjes së përfshirjes, rritet edhe vetëdija dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e edukimit parashkollor/parafillor.



F12. Përqindja e komunave që kanë IP publike

4.8.3 Orari i punës së edukatoreve të moshës 5-6 vjet, në institucione parashkollore publike (qëndrim ditor)

Në bazë të të dhënave, në 45% të komunave, edukatorët e institucioneve parashkollore publike, punojnë një edukatore me një grup, pra 8 orë pune, ndërkaq në 55% të komunave, punojnë 2 edukatore me një grup dhe me dy ndërrime, njëra paradite e tjetra pasdite. D.m.th. nuk kemi unifikim të kësaj çështjeje shumë kyçe për edukimin parafillor në institucionet parashkollore publike.

Kjo çështje është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ 19/2016. Mosrespektimi i këtij udhëzimi, është pasojë e kësaj gjendje. Po ashtu, është në kompetencën e komunës që të zbatojë këtë udhëzim, por është edhe përgjegjësi e inspektoratit të arsimit

në nivel regjional dhe qendror, që lejon, nivelin lokal të mos realizojë udhëzimin administrativ.




Figura 13. Orari i punës së edukatoreve në realizimin e punës së tyre në IP publike

4.8.4 Komunitet që kanë apo nuk kanë qendër me bazë në komunitet – QBK

Sipas të dhënave që i kemi siguruar nga Drejtoritë Komunale të Arsimit, vetëm 30% e komunave posedojnë Qendra me Bazë në Komunitet, 63% e komunave nuk kanë fare, kurse 7% e komunave, nuk janë as të informuara a kanë qendra të tilla apo jo.

Të dhënat e këtyre qendrave me bazë në komunitet për numrin e fëmijëve të përfshirë në to, asnjë komunë nuk vendos në sistemin SMIA, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Këto të dhëna mbesin pa u regjistruar në sistem, prandaj mbesin edhe pa u marrë parasysh kur planifikohet në nivel qendror dhe lokal, e pastaj edhe pa mbështetje adekuat.




Figura 14. Përqindja e komunave që kanë qendra me bazë në komunitet-QBK

4.8.5 Orari i punës së edukatoreve parfilllore në QBK

Në QBK në 56 % të këtyre qendrave, edukatorët punojnë një edukatore me një grup, dhe 44% e QBK edukimin parafillor e realizojnë me dy grupe.




Figura 15. Orari i punës së edukatoreve në realizimin e punës së tyre në QBK

4.9. Përgatitja profesionale e edukatoreve parafillor

Kriteret për pranimin e edukatoreve në punë janë të përcaktuara me Ligjin për Edukimin Parashkollor (2006). Sipas këtyre kriterëve, fakulteti i edukimit drejtimi-parashkollor, duhet të jetë kriteri i parë për pranim të edukatores në punë me fëmijët e moshave 3-6 vjet. Në mungesë të edukatoreve që kanë këtë përgatitje, atëherë mund të merren parasysht kriteret tjera për pranim, siç janë: Shkolla e Lartë Pedagogjike- drejtimi parashkollor, Fakulteti Filozofik- dega Pedagogji dhe diploma të fakulteteve arsimore, të plotësuara me trajnime adekuate për edukatorë parashkollorë e të certifikuar nga MASHT-i.

Rezultatet nga terreni, për përgatitjen profesionale të edukatoreve që punojnë me fëmijët e moshës 5-6vjeç, janë këto:

73% Fakulteti i Edukimit-drejtimi Parashkollor

10% Fakulteti i Edukimit- drejtimi mësim klasor

7% Shkolla e Lartë Pedagogjike për edukatore

8% Pedagogji

1% Drejtime tjera

Bazuar në këto të dhëna, 10% e numrit të edukatoreve me drejtim mësim klasor del të jetë jashtë kriterëve të parapara me ligj, prandaj, edhe kjo duhet të jetë një rekomandim për MASHT dhe DKA, që kjo situatë të përmirësohet dhe të merret parasysht, që përzgjedhja e edukatoreve të bëhet sipas kriterëve.




Figura 16. Përgatitja profesionale e edukatorëve parafillorë

4.10. Gatishmëria e komunave për të përfshirë të gjithë fëmijët në edukimin parafillor

Sipas rezultateve, 3% e komunave kanë në plan të ndërtojnë institucione publike parashkollore, ku do të përfshihen edhe fëmijët parafillor; 57% e komunave do të formojnë klasë të reja në kuadër të shkollave fillore të mesme të ulta; 20% e komunave do të zbatojnë Udhëzimin administrativ 19/2016¹, 7% e komunave

¹ Udhëzimi Administrativ 19/2016 për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë.

Sipas këtij udhëzimi, neni 5, pika 14: Për moshën 5-6vjeç, edukatorët që punojnë në paralelet parafillore në kuadër të shkollave fillore, duhet të punojnë nga 5 orë punë të drejtpërdrejt me fëmijët dhe 1 orë përgatitje për punë edukative, duke përcjellë 2 grupe. Raporti edukatore-fëmijë për këtë grupmoshë është 1:18 maksimumi i lejuar është 20 fëmijë në grup. Njëri grup 2 orë e 30 minuta, grupi tjetër 2 orë e 30 minuta, në total norma 5+1.

nuk kanë buxhet për të zgjeruar hapësira për të përfshirë më shumë fëmijë në parafillor; 10% e komunave i kanë të gjithë fëmijët e moshës 5-6vjeç, të përfshirë në edukimin parafillor, dhe 3% kanë pak fëmijë për të formuar grupe për edukim parafillor.

Bazuar në këto të dhëna, vetëm 10% e komunave kanë të përfshirë 100% të fëmijëve në edukim parafillor. Sigurisht se kjo është një përqindje e vogël e komunave që kanë arritur këtë përqindje, krahasuar me synimet që ky nivel i edukimit të bëhet i obliguar.

Krahasuar me përqindjen në nivel vendi, ku 19.8% e fëmijëve të moshës 5-6 vjeç, janë të papërfshirë, atëherë, me përkushtimin më të madh të komunave për këtë nivel të edukimit, sigurisht se do të arrihet që të gjithë fëmijët e kësaj moshe të përfshihen në edukim parafillor, në të gjitha komunat. Kur të arrihet që të përfshihen të gjithë fëmijët, atëherë, kjo tregon se janë krijuar kushtet që të marrin shërbimet edukative të gjithë fëmijët, pavarësisht nga ajo a i marrin ato shërbime në shkollë, a në institucion parashkollor publik, a në institucion parashkollor privat, apo në qendra me bazë në komunitet, vetëm që ky edukim të jetë i qëndrueshëm, cilësor dhe të bëhet i obliguar.

Kjo është vështirë të arrihet, pa një përkushtim të nivelit qendror, nivelit lokal dhe komunitetit.




Figura 17. Përqindja e komunave për gatishmërinë e komunave për të përfshirë 100% të fëmijëve në edukimin parafillor në vitin

4.11. Objektet që mund të adaptohen për klasë parafillore

27% e komunave kanë mundësi të adaptojnë objekte për 24 klasë parafillore; 7 % e komunave kanë mundësi sipas nevojës të adaptojnë objekte; 66% e komunave nuk kanë mundësi të adaptojnë klasë parafillore.

Derisa 27 % e komunave kanë mundësi të adaptojnë objekte për 24 klasë parafillore, atëherë këtu nuk kërkohet shumë shpenzime materiale, vetëm një planifikim dhe organizim nga niveli lokal, që të funksionalizohen këto objekte dhe të arrihet të përfshihen fëmijët parafillor në to.




Figura 18. Përqindja e komunave që mund të adaptojnë klasë parafillore

4.12. Komunat që mbështeten nga donatorët

23% e komunave kanë gjithsej 11 klasë që mbështeten nga donatorët, 5 edukatore që financohen nga donatorët dhe 1 edukatore që financohet nga prindërit; ndërsa 77% e komunave nuk kanë klasë as edukatore, që mbështeten nga donatorët. Të gjitha komunat që kanë bashkëpunim me donatorët kanë marrëveshje të nënshkruara, për punën që e realizojnë, si dhe marrëveshje me prindërit për edukatoren që financohet nga prindërit.

Donacionet e ofruara, nga organizatat e ndryshme që merren me edukimin parafillor, shpeshherë, nuk kanë treguar qëndrueshmëri, sepse kanë realizuar projektet të ndryshme, ku në disa komuna, kanë vazhduar me ato projekte duke i mbështetur nga buxheti komunal, e disa komuna që nuk kanë planifikuar mbështetje

buxhetore pas largimit të projektit, kështu që janë mbyllur qendrat/klasat parafillore me përfundimin e projekteve.

Shfrytëzimi i mundësive të bashkëpunimit të komunave me donatorët ka rëndësi të madhe në krijimin më të mirë të kushteve të punës dhe në ngritjen e cilësisë në këtë nivel të edukimit. Organizatat që kanë ofruar mbështetje nëpër komuna, kanë ndikuar edhe në infrastrukturë, kanë ndërtuar institucione parashkollore, kanë krijuar qendra me bazë në komunitet, kanë ofruar kushte për përfshirje të fëmijëve në zonat e marginalizuara, kanë përkrahur përfshirjen e fëmijëve të të gjitha komuniteteve nëpër QBK dhe nëpër klasa parafillore, kanë rregulluar mjedise edukative, kanë realizuar trajnime profesionale të edukatoreve, kanë furnizuar me mjete didaktike këto institucione edukative, e shumë mbështetje të tjera që kanë ofruar nëpër komuna. Donacionet gjithmonë kanë qenë përkrah komunave në realizimin e edukimit parafillor, por, edhe komunat duhet të kenë parasysh se si t'i vazhdojnë projektet e të kthehen si pjesë e planifikimit buxhetor të komunës, sepse donacionet nuk qëndrojnë gjatë, e nevoja për përkrahje të këtij niveli të edukimit qëndron gjithnjë.




Figura 19. Përqindja e komunave që kanë mbështetje nga donatorët.

4.13. Mundësitë e komunave që në vitin 2016/17 të përfshijnë 100% të fëmijëve në edukimin parafillor

10% e komunave i kanë të përfshirë të gjithë fëmijët në edukim parafillor; 50% e komunave kanë mundësi t'i përfshijnë të gjithë fëmijët parafillor, duke planifikuar më mirë dhe duke e zbatuar Udhëzimin Administrativ 19/2016; 37% nuk kanë mundësi t'i përfshijnë për shkak të buxhetit; dhe vetëm 3% nuk mund të përfshijnë më shumë sepse kanë pak fëmijë për të formuar grupe.

Nga ky rezultat, fokusi i institucioneve qendrore që merren me edukimin parafillor, do të duhej të përqendrohej në 37% të komunave, që për shkak të buxhetit nuk kanë mundësi të përfshijnë të gjithë fëmijët në edukim parafillor. Në këtë rast duhet të intervenohet me mundësitë që kanë, në mbështetje me buxhet, në mbështetje me donatorë, në rregullim të infrastrukturës, etj, sepse rezultatet tregojnë që 50% e komunave, me një planifikim më të mirë mund të arrijnë përfshirjen e të gjithë fëmijëve, pra, kanë mundësi në nivelin lokal ti rregullojnë gjërat, kurse komunat që nuk kanë mundësi as me planifikim të mirë të arrijnë më shumë, atëherë, këtu kërkohet mbështetja e nivelit qendror.

Detyrat dhe përgjegjësitë e komunave dhe të MASHT-it, lidhur me këtë çështje, janë të përcaktuara në Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës.




Figura 20. Përqindja e komunave që kanë mundësi të përmirësojnë gjendjen në përfshirjen e fëmijëve në edukimin parafillor, në vitin 2016/17

4.14. A e posedon DKA-ja, numrin e fëmijëve të lindur në vitin 2011, që në vitin shkollor 2016/2017 janë të moshës 5-6 vjeç?

Duke marrë parasysh që hulumtimi është realizuar në periudhën prill- maj 2016, rezultatet tregojnë se vetëm 10% e drejtorive komunale të arsimit kanë të dhëna për numrin e fëmijëve të lindur në vitin 2011, e që në vitin shkollor 2016/2017 do të regjistrohen në klasën parafillore. Ndërsa, 90% e drejtorive komunale të Arsimit nuk kanë të dhëna për fëmijët e lindur në vitin 2011. Kjo tregon se interesimi i komunave, për të përfshirë në edukim parafillor të gjithë fëmijët, është minimal. Sepse po të ekzistonte interesimi më i madh i drejtorive komunale të arsimit, do të merrnin masa dhe veprime konkrete paraprakisht, për të siguruar të dhënat për numrin e fëmijëve të lindur në vitin 2011, dhe

saktësisht do të dinin sa fëmijë të moshës 5-6 vjeç do t'i kenë në vitin shkollor 2016/2017, e po ashtu do t'i bënin përgatitjet me kohë, për të përfshirë të gjithë fëmijët. Përndryshe, nëse presin, vetëm sa fëmijë regjistrohen vet në klasat parafillore, kështu nuk mund të përfshihen të gjithë fëmijët, për arsye se nuk do të jenë të përgatitura kushtet për të gjithë.

Fëmijët regjistrohen në klasë parafillore aty ku ka kushte dhe mundësi, ndërsa, aty ku nuk ka kushte (p.sh. punësimi i një edukatoreje, krijimi i hapësirave për klasë parafillore, krijimi i kushteve për të udhëtuar në një shkollë tjetër, për fëmijët që jetojnë në fshatrat ku nuk mund të formojnë grup të fëmijëve, për arsye se ka pak fëmijë, etj), nuk kanë mundësi fëmijët të përfshihen në këtë nivel të edukimit.

Prandaj, DKA, para se të bëjë planifikimin për vitin e ri shkollor, duhet të marr listat dhe numrin e fëmijëve që kanë moshën 5-6 vjeç, nga qendrat e vaksinimit, ose në zyrën për regjistrim civil, në mënyrë që përfshirjen e këtyre fëmijëve në edukim parafillor, ta planifikojë me kohë.




Figura 21. Përqindja e komunave që posedojnë listat e fëmijëve të lindur në vitin 2011 që në vitin 2016/17, regjistrohen në klasë të parë.

4.15. Sigurimi i listave dhe numrit të fëmijëve që kanë moshën për t'u regjistruar në klasë parafillore, nga DKA-ja

43% të drejtorive komunale të arsimit e marrin numrin e fëmijëve që do të fillojnë klasën parafillore, në qendrën e regjistrimit civil, 14% e marrin numrin e fëmijëve në qendrën e vaksinimit, ndërsa 43% e drejtorive komunale të arsimit nuk marrin evidenca fare. Këta të fundit vetëm regjistrojnë fëmijë aq sa lajmërohen vet për t'u regjistruar dhe sa kanë kushte e mundësi për të ofruar.

Edhe komunitat që marrin listat me emrat e fëmijëve në qendrën e regjistrimit civil, i marrin ato në fund të muajit gusht, për fëmijët që do të jenë parafillor në shtator, e që është vonë, sepse atëherë nuk ka mundësi të krijohen kushte, për të gjithë fëmijët, por ato duhet kërkuar më herët në mënyrë që komuna t'i sigurojë kushtet për t'i përfshirë të gjithë fëmijët.




Figura 22. Përqindja e komunave që sigurojnë listat e fëmijëve për regjistrim në klasë të parë

5. SFIDAT E NIVELIT LOKAL PËR PËRFSHIRJEN E TË GJITHË FËMIJËVE NË EDUKIMIN PARAFILLOR

Pamundësia e krijimit të vende të reja të punës për edukatore

Kjo sfidë ka të bëjë me nivelin qendror, por mund të themi se është vështirësi edhe e nivelit lokal, për arsye se në të shumtën e rasteve nuk bëhet planifikimi me kohë, për të kërkuar dhe arsyetuar nevojën për punësim të edukatoreve të reja. Si pasojë e kësaj, MAS nuk e pranon me kohë kërkesën dhe dërgohen me vonesë në Ministri të Ekonomisë dhe Financave, ka pastaj, gjërat që nuk planifikohen me kohë, nuk mund të aprovohen. Prandaj, edhe pse këto kërkesa aprovohen nga niveli qendror, shpesh janë pjesë e planifikimit të nivelit lokal. Por, ka raste kur edhe janë planifikuar me kohë nga niveli lokal, të mos ketë mundësi financiare nga niveli qendror. Prandaj, duhet të ketë koordinim të qartë dhe mbështetje të dyanshme për të arritur qëllimin, që ky nivel i edukimit të përkrahet dhe të realizohet me përfshirje të 100% të fëmijëve.

Pamundësia e krijimit të hapësirave për klasa parafillore

Duke u bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi, 19.8% e fëmijëve, në nivel vendi, shkojnë në klasë të parë, pa vijuar më parë edukimin parashkollor. Kjo gjendje, duhet t'i bëjë edhe nivelin lokal edhe nivelin qendror, që të merren më për së afërmi me hulumtimin, planifikimin dhe realizimin e kësaj çështjeje shumë të rëndësishme, përfshirjen e të gjithë fëmijëve në edukimin parafillor.

Duke e vlerësuar si duhet edukimin në fëmijërinë e hershme dhe duke krijuar kushte që ky nivel i edukimit të realizohet me cilësi dhe në kohën e duhur, i japim mbështetje edukimit dhe zhvillimit të gjeneratave të reja, jo vetëm për t'u përgatitur për shkollë, por edhe për jetë. Prandaj, përfshirja e të gjithë fëmijëve në edukimin parafillor është me të vërtetë nevojë urgjente, sepse po t'i kushtohet më shumë rëndësi institucionale qendrore dhe lokale, do të krijoheshin kushtet që shërbimet edukative, të merrnin fëmijët nga mosha 0-6vjeç, jo vetëm 5-6vjeç.

Krijimi i kushteve për edukim të fëmijëve me nevoja të veçanta

Në këtë hulumtim, nuk janë mbledhur të dhëna për numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshirë në edukimin parafillor, por, duke marrë parasysh që këtyre fëmijëve duhet t'u kushtohet rëndësi më shumë dhe përfshirja e këtyre fëmijëve në këtë nivel të edukimit, është paraqitur si e rëndësishme së veçantë edhe nga niveli lokal, atëherë duhet të kemi parasysh që fëmijët me nevoja të veçanta të janë të përfshirë në këtë nivel të edukimit dhe të mos përjashtohen e diskriminohen.

Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në edukim është e rregulluar me ligj. Vetëm nevojitet përkushtimi për të përfshirë më shumë fëmijë me nevoja të veçanta në edukimin parafillor dhe krijimin e kushteve për këta fëmijë, e këtë duhet të bëjnë, së pari prindërit e fëmijës (duke kërkuar edukim dhe mirëqenie për fëmijën e vet), pastaj drejtori i shkollës, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Krijimi i mundësive për përfshirjen e fëmijëve nga zonat e thella rurale në edukimin parafillor

Kjo me të vërtetë është një problematikë edhe për fëmijët e niveleve më të larta të shkollimit, jo vetëm për fëmijët parafillor, por, duke u bazuar në legjislacionin që kemi, atëherë mund t'u krijohen mundësi edhe fëmijëve të fshatrave të lagëta nga vendbanimet urbane, edhe fëmijëve që janë pak në numër në këto fshatra, që të kenë mundësi të vijojnë edukimin, në mos para moshës 5 vjeç, atëherë të paktën nga moshja 5 vjeç.

Nevojitet planifikim në nivel komune se si të rregullohet përfshirja e këtyre fëmijëve në edukimin parafillor, duke siguruar transport për bartjen deri aty ku është e mundur të krijohet një grup, të zbatohet udhëzimi administrativ UA 19/2016, për orarin e punës së edukatores, etj.

Frekuentimi i fëmijëve parafillor nga fshatrat, në shkollat e qytetit

Edhe kjo sfidë, që vjen nga zyrtarët komunal të arsimit, duhet të analizohet dhe të shqyrtohet në nivelin lokal dhe të zbatohet sipas kriterëve ligjore për rajonalizimin e shkollave. Prandaj, menxhmenti i shkollës duhet t'i kushtojë rëndësi kësaj çështjeje gjatë regjistrimit të fëmijëve në klasët parafillore. Në rast se shkollat, në fshatrat e afërta, kanë klasë parafillore, atëherë fëmijët duhet të regjistrohen në shkollën më të afërt, e nëse shkolla e afërt nuk ka klasë parafillore, atëherë, komuna vendos se ku do të përfshihen fëmijët e këtyre fshatrave në edukimin parafillor.

6. KONKLUDIME

Nga ky hulumtim mund të konkludojmë se pyetjet e hulumtimit kanë rezultuar me këto gjetje:

- Niveli lokal ende nuk është i gatshëm të krijojë kushte dhe mundësi që të gjithë fëmijët të vijnë në edukimin parafillor. Krijimi i këtyre kushteve do të ishte parakusht që edukimi parashkollor të bëhet edukim i obliguar. Në nivel vendi, janë edhe 19.8%, e fëmijëve të kësaj moshe, që janë jashtë përfshirjes në këtë nivel të edukimit
- Vetëm 10% e komunave kanë arritur të krijojnë kushte që të përfshijnë të gjithë fëmijët në edukim parafillor. Bazuar në reflektimin nga terreni, komunat ende nuk kanë arritur këtë, nuk kanë dhënë shpresë se do të ndodh shpejtë krijimi i kushteve dhe përfshirja 100% e fëmijëve, për arsye se 37% e komunave, edhe në planifikimin 2016/2017, nuk kanë paraparë që kjo gjendje të ndryshojë.
- Sfidat e paraqitura, nuk janë të patejkalueshme, por mungon planifikimi dhe prioritetizimi në nivelin komunal për të realizuar obligimet që i caktohen në Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës; në dispozitat ligjore të Ligjit për Arsim Parauniversitar (2011); në UA 19/2016, në Ligjin për Edukimin Parashkollor, si dhe në koordinimin me nivelin qendror.
- Këto rezultate tregojnë se hipoteza e ngritur është vërtetuar, sepse, janë 127 shkolla me një shtrirje në 90% të komunave, që ende nuk kanë klasë parafillore.

- Mosrealizimi i edukimit parafillor si i obliguar, ndikon edhe në cilësinë e edukimit në nivelet më të larta, kur fëmijët nuk marrin asnjë shërbim edukativ institucional deri në fillimin e klasës së parë.

7. REKOMANDIME

7.1. Rekomandimet për MASHT

- Të krijohen mundësi që të rritet numri i edukatoreve në komuna për të përfshirë të gjithë fëmijët në edukim parafillor;
- Të monitorohet realizimi i UA 19/2016, në secilën komunë dhe përfshirja e fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në edukim parafillor;
- Të realizohen fushata vetëdijësuese për rëndësinë e edukimit parafillor, me nivelin lokal dhe me komunitetin;
- Të fuqizohet edukimi parafillor në nivelin lokal;
- Të monitorohet cilësia e këtij niveli;

7.2. Rekomandime për Komunitetin

- Të planifikohet me kohë rritja e numrit të edukatoreve
- Të krijohen mundësitë infrastrukturore për klasë parailllore
- Të sigurohen të dhënat nga Qendra e Regjistrimit Civil dhe nga Qendra e Vaksinimit, për fëmijët që do të jenë në klasë parafilllore në vitin vijues.

- Të zbatohet UA 19/2016 për orarin e edukatoreve
- Të sigurohet transporti për fëmijët e zonave rurale
- Të kërkohen donator për të mbështetur këtë nivel të edukimit
- Të sigurohet cilësi në këtë nivel të edukimit

LITERATURA

1. Britto, P.R., Ravens, V.J., Ponguta, A.L. (2011). *Joined Hands Better Childhood*.
[http://www.unicef.org/kosovoprogramme/Joined_Hands_ENG_web.pdf] shfrytëzuar në Janar 2014]
2. Deva-Zuna, Afërdita (2003) Edukimi i parashkollorit në familje, Prishtinë, f 48
3. HMO Solution, (2007). *Budget and legal analysis of early childhood education in Kosovo*.
Commissioned by Save the Children Alliance in Kosovo
4. Instituti i Studimeve Pedagogjike (2002) Parashkollori, Tiranë, f 44
5. MAShT, (2006). *Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç*.
6. MAShT, (2006). *Ligji mbi edukimin parashkollor*.
7. MAShT, (2006). *Standarde të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç*.
8. MAShT, (2008). *Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës*.
9. MAShT, (2016). *Draft - Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2017-2021 (PSAK)*
10. MAShT, (2011). *Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës*.
11. MAShT, (2011). *Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6vjet*

12. MASH-T - IPK, (2013) . Raport mbi përfshirjen e fëmijëve 5-6 vjeç në arsimin parafillor.
13. Save the Children, (2014) Roli i institucioneve dhe i mësuesve për të krijuar partneritet në mbështetje të prindërve në zhvillimi tërësor të fëmijëve, Tiranë, f 18
14. **Udhëzimi Administrativ 19/2016** Për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë.
15. Vadahi, Fatmir, (2002) Pedagogjia Parashkollore, Shkodër, f 125

SHTOJCAT



Pyetësor për zyrtar komunal të arsimit

I/e nderuar,

Instituti Pedagogjik i Kosovës, në bashkëpunim me Divizionin për Edukim Parashkollor në MAShT, e kanë parë të nevojshme që të realizojnë një hulumtim për të marrë informata nga secila Drejtori Komunale e Arsimit në nivel të Kosovës, në mënyrë që ta kemi një pasqyrë më konkrete të përfshirjes aktuale të fëmijëve të moshës 5-6 vjet, në klasën parafillore, si dhe një pasqyrë të sfidave dhe mundësive të secilës komunë, për përfshirjen e të gjithë fëmijëve të kësaj moshe, në këtë nivel edukimi, i cili do të bëhet i obliguar ashtu sikurse edhe e parashih Ligji për Arsimin Parauniversitar.

Hulumtimi do të shërbejë për vlerësimin e gjendjes aktuale dhe për hartimin e politikave arsimore për fëmijët e kësaj moshe.

Të gjitha pyetjet, lidhen me informatat të cilat Drejtoria Komunale e Arsimit, i ka në kompetencë të saj. Për këtë edhe ju kemi drejtuar juve.

Paraprkisht ju falënderojmë për bashkëpunimin!

Komuna: _____

Emri dhe mbiemri i zyrtarit që plotëson pyetësorin:

Pozita: _____

Numri i tel: _____

P1	A keni informacione se janë duke u bërë përpjekje që klasa parafillore të bëhet e obliguar?	
	Po ☐	Jo ☐
P2	Sa është numri i klasave parafillore në kuadër të shkollave në komunën tuaj?	
	Shëno numrin 	Nuk e di ☐
P3	Sa është numri i grupeve të fëmijëve 5-6 vjeç në institucionet parashkollore publike në komunën tuaj?	
	Shëno numrin 	Nuk e di ☐
P4	A keni të dhëna sa institucione parashkollore private janë në komunën tuaj?	
	Po, shëno numrin 	Nuk e di ☐
P5	Sa grupe të fëmijëve të moshës 5-6 vjeç janë në institucione parashkollore private ?	
	Shëno numrin 	Nuk e di ☐
P6	Sa është numri i fëmijëve të përfshirë në edukimin parafillor në shkolla?	
	Femra: Shëno numrin Meshkuj: Shëno numrin Gjithsej: Shëno numrin	Nuk e di ☐

P7	Sa është numri i fëmijëve të moshës 5 – 6 vjeç në institucionet publike parashkollore në komunën tuaj?		
	Femra: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ Meshkuj: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐ Gjithsej: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐	Nuk e di PP ☐	
P8	Sa është numri i fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në institucionet parashkollore private në komunën tuaj? (nëse keni të dhëna)		
	Femra: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ Meshkuj: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐ Gjithsej: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐	Nuk e di ☐	
P9	A ka qendër me bazë në komunitet (QBK), në komunën tuaj?		
	Po, Shëno numrin e tyre ☐ ☐ ☐	Jo ☐	Nuk e di ☐
P10	A regjistrohen në SMIA fëmijët e qendrave me bazë në komunitet të komunës tuaj?		
	Po ☐	Jo ☐	Nuk e di ☐
P11	Sa është numri i fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në këto qendra? (nëse keni të dhëna)		
	Femra: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ Meshkuj: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐	Nuk e di/ PP ☐	

	Gjithsej: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐			
P12	A ka shkolla që nuk ka klasë parafillore në komunën tuaj?			
	Po, Shëno numrin e tyre ☐ ☐ ☐	Jo ☐	Nuk e di ☐	
P13	Klasat parafillore në shkolla, funksionojnë në:			
	Klasë të veçanta Sa klasë? ☐ ☐ ☐	Klasë ku mësojnë edhe nxënësit e klasave tjera Sa klasë? ☐ ☐ ☐	Është objekt i veçantë Sa klasë? ☐ ☐ ☐	
P14	Sa edukator/edukatore punojnë me klasë para-filllore në shkolla, në komunën tuaj?			
	Edukatore (F) ☐ ☐ ☐	Edukator (M) ☐ ☐ ☐	Gjithsej ☐ ☐ ☐	Nuk e di ☐
P15	Sa edukator/edukatore punojnë me grupet e fëmijëve 5-6 vjet në kuadër të institucioneve publike parashkollore?			
	Edukatore (F) ☐ ☐ ☐	Edukator (M) ☐ ☐ ☐	Gjithsej ☐ ☐ ☐	Nuk e di ☐
P16	Sa edukator/edukatore punojnë me grupet e fëmijëve 5-6 vjeç në kuadër të institucioneve private parashkollore?			
	Edukatore (F) ☐ ☐ ☐	Edukatorë (M) ☐ ☐ ☐	Gjithsej ☐ ☐ ☐	Nuk e di ☐
P17	Sa edukator/edukatore punojnë me fëmijët të moshës 5-6 vjeç në qendrat me bazë në komunitet (QBK)			
	Edukatore (F) ☐ ☐ ☐	Edukatorë (M) ☐ ☐ ☐	Gjithsej ☐ ☐ ☐	Nuk e di ☐
P18	Me sa ndërrime punojnë edukatorët me klasë parafillore në shkollë?			
	Me një ndërrim ☐	Me dy ndërrime ☐	Nuk e di ☐	

P19	Me sa ndërrime punojnë edukatorët që punojnë me parafillorët në institucion parashkollor?		
	Me një ndërrim ☐	Me dy ndërrime ☐	Nuk e di ☐
P20	Me sa ndërrime punojnë edukatorët në qendrat me bazë në komunitet QBK?		
	Me një ndërrim ☐	Me dy ndërrime ☐	Nuk e di ☐
P21	Përgatitja profesionale e edukatoreve - sa janë me:		
	Fakultet të edukimit –Drejtimi parashkollor ☐ ☐ ☐ Fakultet të edukimit – Drejtimi mësim klasor ☐ ☐ ☐ Shkollë të Lartë Pedagogjike ☐ ☐ ☐ Fakultet Filozofik - Drejtimi Pedagogji ☐ ☐ ☐ Me drejtime tjera, jashtë profilit ☐ ☐ ☐ Nuk e di/ PP ☐		
P22	A ka komuna juaj plan për t'i përfshirë të gjithë fëmijët e moshës 5-6 vjeç në edukim parafillor?		
	Po ☐	Jo ☐	
P22.1	Nëse PO, si do të organizojë këtë përfshirje: (vendos X në hapësirën përkatëse)		
	Formon klasë të reja në kuadër të shkollave ○ Ndërton Institucion Parashkollor ku do të përfshijë edhe fëmijët e moshës 5-6 vjeç ○ Formon klasë të reja në kuadër të institucioneve parashkollore aktuale ○ Ndërton objekt të ri afër shkollës ○ Rregullon orarin e punës së edukatoreve që të punojnë me dy ndërrime, sipas UA 19 /2016 ○		

	Transporton fëmijët e moshës 5-6 vjeç në shkollat tjera, ku ka mundësi të përfshihen fëmijët në edukimin parafillor ☐ Ndonjë formë tjetër _____ Nuk e di/ PP ☐	
P22.2	Nëse JO, pse nuk keni planifikuar lidhur për këtë nivel të edukimit?	
	Nuk keni informata të mjaftueshme për këtë ☐ Nuk keni mundësi financiare ☐ Nuk keni personel profesional adekuat - edukatore ☐ Tjetër _____ _____ Nuk e di/ PP ☐	
P23	A ka në komunën tuaj ndonjë objekt, i cili mund të adaptohet si klasë parafillore?	
	Po ☐ <i>Nëse PO, sa klasë mund të adaptohen për shfrytëzim, për parafillorët?</i> ☐ ☐ ☐	Jo ☐
P24	A ka në komunën tuaj klasë parafillore që mbështetet nga donatorët?	
	Po ☐ <i>Nëse PO, sa klasë mbështeten nga donatorët?</i> ☐ ☐ ☐	Jo ☐
P25	A ka në komunën tuaj edukatorë që mbështetet nga donatorët?	
	Po ☐ Nëse PO, sa edukatorë? ☐ ☐ ☐	Jo ☐
P26	A keni marrëveshje bashkëpunimi me ndonjë donator për klasë parafillore apo për qendër me bazë në komunitet?	
	Po ☐ Nëse PO, me cilët donatorë? 1. _____	Jo ☐

	2. _____ 3. _____	
P27	A ka komuna juaj kapacitet dhe mundësi që në vitin shkollor 2016/2017 të përfshijë 100 % të fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në edukimin parafillor?	
	Po ☐	Jo ☐ Nëse Jo, pse? _____ _____ _____
P28	A e ka Drejtoria Komunale e Arsimit numrin e fëmijëve të lindur në vitin 2011 (në komunën tuaj), që tani kanë moshën 5 vjeç e që janë të moshës për t'u regjistruar në klasën parafillore?	
	Po ☐ Nëse PO, sa është numri i tyre? ☐ ☐ ☐ ☐	Jo ☐
P29	Si i siguronit statistikën për numrin e fëmijëve të moshës 5-6 vjeç që në vitin 2016/2017 do të regjistrohen në klasën parafillore?	
	Në qendrën e vaksinimit të fëmijëve ☐ Në qendrën për regjistrim civil ☐ Nuk keni evidenca ☐	
P 30	Sfidat me të cilat ballafaqohet drejtoria e arsimit për edukimin parafillor në komunën tuaj?	

IPK ju falënderon për ndihmën tuaj në plotësimin e pyetësorit!

Pyetësor

I/e nderuar,

Instituti Pedagogjik i Kosovës në bashkëpunim me Divizionin për Edukim Parashkollor në MAShT, e kanë parë të nevojshme që të realizojnë një hulumtim, në mënyrë që ta kemi një pasqyrë më konkrete të përfshirjes aktuale të fëmijëve të moshës 5-6vjeç, në edukimin parafillor, (numrin e fëmijëve që në shtator të vitit 2016 fillojnë klasën e parë).

Hulumtimi do të shërbejë për vlerësimin e gjendjes aktuale dhe për hartimin e politikave arsimore për këtë nivel të edukimit. Janë duke u bërë përpjekje që të përfshihen të gjithë fëmijët e moshës 5-6vjeç në edukim parafillor si dhe nivel i edukimit të bëhet i obliguar.

Paraprakisht ju falënderojmë për bashkëpunimin!

Komuna: _____

Emri i institucionit parashkollor _____

Emri dhe mbiemri i personit që plotëson pyetësorin:

Pozita: _____

Numri i tel: _____

e-mali: _____

P1	A keni informacione se janë duke u bërë përpjekje që klasa parafillore të bëhet e obliguar?	
	Po ☐	Jo ☐
P2	Sa grupe të fëmijëve 5-6 vjeç ka në kopshtin tuaj?	
	Shëno numrin	
P3	Sa është numri i fëmijëve parafillor në kopshtin tuaj?	
	Femra: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ Meshkuj: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ Gjithsej: Shëno numrin ☐ ☐ ☐ ☐ ☐	
P4	Sa edukatorë punojnë me fëmijët parafillor ?	
	Shëno numrin:	
P5	Përgatitja profesionale e edukatoreve që punojnë me fëmijët e moshës 5-6 vjeç - sa janë me:	
	Fakultet të edukimit –Drejtimi parashkollor ☐ ☐ ☐ Fakultet të edukimit – Drejtimi mësim klasor ☐ ☐ ☐ Shkollë të Lartë Pedagogjike ☐ ☐ ☐ Fakultet Filozofik - Drejtimi Pedagogji ☐ ☐ ☐ Me drejtime të tjera, jashtë profilit ☐ ☐ ☐ Nuk e di/ PP ☐	
P 6	Ndonjë koment lidhur me edukimin parafillor?	

IPK ju falënderon për plotësimin e pyetësorit!

**Pyetësor për zyrtar të Agjencionit të
Regjistrimit Civil – ARC**

Instituti Pedagogjik i Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, është duke bërë hulumtimin për përfshirjen e fëmijëve e moshës parafillore në edukimin parafillor, si dhe sfidat dhe gatishmëria e komunave për të realizuar edukimin parafillor si edukim të obliguar. Të dhënat që do t'i plotësoni në këtë pyetësor, janë të domosdoshme për realizimin e politikave të MASHT-it dhe për planifikim të zhvillimit të mëtutjeshëm të edukimit të këtij niveli.

Prandaj ju lutemi, që ju si kompetent, të na i dërgoni të dhënat që kërkohen nga ky pyetësor, për të gjitha komunat e Kosovës.

Paraprakisht, ju falënderojmë për bashkëpunimin!

1. Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2010 (në total, në nivel Kosove)
(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2010 sipas komunave
(shënon: komunat të gjitha, pastaj, për secilën: femra, meshkuj, gjithsej)

Komuna _____

(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

2. Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2011 (në total, në nivel Kosove)
(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2011 sipas komunave
(shënon: komunat të gjitha, pastaj, për secilën: femra,
meshkuj, gjithsej)

Komuna _____
(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

3. Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2012 (në total, në nivel Kosove)
(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2012 sipas komunave
(shënon: komunat të gjitha, pastaj, për secilën: femra,
meshkuj, gjithsej)

Komuna _____
(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

4. Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2013 (në total, në nivel Kosove)
(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2013 sipas komunave
(shënon: komunat të gjitha, pastaj, për secilën: femra,
meshkuj, gjithsej)

Komuna _____
(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

5. Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2014 (në total, në nivel Kosove)
(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2014 sipas komunave
(shënon: komunat të gjitha, pastaj, për secilën: femra,
meshkuj, gjithsej)

Komuna _____
(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

6. Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2015 (në total, në nivel Kosove)
(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

Numri i fëmijëve të lindur në vitin 2015 sipas komunave
(shënon: komunat të gjitha, pastaj, për secilën: femra,
meshkuj, gjithsej)

Komuna _____
(femra) _____ (meshkuj) _____ gjithsej _____

Faleminderit!

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja “Blendi” Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

373.2(047)

Aliu-Gashi, Mevlude

Sfidat dhe gatishmëria e nivelit lokal për realizimin e edukimit parafillor si edukim i obliguar: raport hulumtimi /Mevlude Aliu-Gashi, Zehrie Plakolli. - Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2016. – 69 f. ilustr. me ngjyra; 21 cm.

Literatura : f. 55

1. Plakolli, Zehrie

ISBN 978-9951-591-38-6

ISBN 978-9951-591-38-6



9 789951 591386